



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6, dhe në pajtim me nenin 19 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

V E N D I M

për kredi të disponueshme njëditore
(tekst i spastruar jozyrtar)¹

1. Me këtë vendim rregullohen kushtet dhe mënyra e miratimit të kredisë së disponueshme njëditore (në tekstin vijues: kredi njëditore), për të kënaqur nevojën afatshkurtër të likuiditetit të bankave.

2. Të drejtën e kredisë njëditore e kanë të gjitha bankat dhe filialet e bankave të huaja (në tekstin vijues: bankat).

3. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin vijues: Banka Popullore) miraton kredi njëditore bankave përmes lidhjes së transaksioneve repo me afat maturmi prej një ditë pune (njëditore).

4. Për kredinë e miratuar njëditore Banka Popullore ngarkon interes me normë interesi që fitohet duke shtuar 0,50 pikë përqindje në normën e interesit të bonove të thesarit.

Në rastin e aplikimit të tenderit me normë interesi, norma e interesit të kredisë njëditore fitohet duke shtuar 0,50 pikë përqindje të normës mesatare të ponderuar të interesit të arritur në ankandin e fundit të bonove të thesarit.

Interesi nga paragrafi 1 i kësaj pike llogaritet me aplikimin e metodës së interesit të thjeshtë.

5. Si instrumente për sigurimin e kredisë njëditore përdoren letrat me vlerë të shënuara në listën e letrave me vlerë për zbatimin e operacioneve monetare.

6. Kredia njëditore miratohet me kërkesë të bankës.

Banka Popullore ka të drejtë të kufizojë miratimin ose të refuzojë kërkesën për kredi njëditore.

7. Kërkesa për lidhjen e kredisë njëditore, gjegjësisht kërkesa për konvertimin e kredisë brenda ditës në kredi njëditore i përmban elementët në vijim:

- shuma monetare në denarë;
- shenjë e letrave me vlerë (ISIN, gjegjësisht shenjë e ankandit);
- shuma nominale e letrave me vlerë;
- llogari në Sistemin ndërbankar të pagesave në Maqedoni (në tekstin vijues: MIPS);
- llogari e letrave me vlerë në Depozitën Qendrore të Letrave me Vlerë SH.A. Shkup, nëse përdoren letrat me vlerë të regjistruara pranë këtij institucioni.

¹ Ky paraqet tekst jozyrtar të spastruar të Vendimit për kredi të disponueshme njëditore. Teksti jozyrtar i spastruar i Vendimit për kredi të disponueshme njëditore përfshin Vendimin për kredi të disponueshme njëditore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.42/11) dhe Vendimin për ndryshimin e Vendimit për kredi të disponueshme njëditore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.49/12).

Kërkesa për kredi njëditore, gjegjësisht kërkesa për konvertimin e kredisë brenda ditës në kredi njëditore banka e dorëzon në Bankën Popullore përmes Sistemit Elektronik të Bankës Popullore për operacione të tregut (në tekstin vijues: Sistemi Elektronik), gjatë çdo dite pune, nga momenti kur MIPS ndalon marrjen e mesazheve të transferimit të mjeteve nga mbajtësit e qarkullimit pagesor për klientët e tyre deri në momentin kur MIPS ndalon marrjen e mesazheve të transferimit të mjeteve nga mbajtësit e qarkullimit pagesor, sipas planit të rregullt afatshkurtër të MIPS-it dhe është i parevokueshëm.

8. Për kredinë e miratuar njëditore, nëpërmjet Sistemit Elektronik përgatitet përfundim në pajtim me Kontratën e Përgjithshme Repo.

9. Në rast të problemeve teknike gjatë përdorimit të Sistemit Elektronik, banka mund ta dorëzojë kërkesën në Bankën Popullore me telefaks ose në mënyrë tjetër të njoftimit me shkrim. Banka Popullore e njofton bankën për kredinë e miratuar njëditore me telefon, telefaks ose mënyrë tjetër të njoftimit.

10. Banka është e detyruar të kthejë kredinë njëditore ditën e ardhshme të punës së MIPS, si transaksioni i parë i pagesës i iniciuar nga banka.

11. Nëse banka nuk e kthen kredinë njëditore, Banka Popullore ngarkon kredinë dhe të gjitha kërkesat në bazë të kredisë me përfshirje të plotë të instrumenteve për siguri.

12. Shlyerja e kredisë njëditore kryhet në bazë të elementeve të përcaktuara në konkluzion, dhe në pajtim me Rregullat për mënyrën dhe procedurën e tregtimit dhe shlyerjes së transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet përmes sportelit, Standardi për qëllimin dhe formatin e mesazheve MT 199 në Sistemin e Kryqëzimit, Standardi për qëllimin dhe formatin e mesazheve në MIPS dhe Udhëzimi për shlyerjen e transaksioneve me bono thesari të emetuara.

13. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi pushon të vlejë Vendimi për kredinë e disponueshme njëditore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 84/2005).

14. Ky Vendim hyn në fuqi me ditën e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.

Guvernator
dhe kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
м-р Петар Гошев